Aksionarët e pranishëm/ të përfaqësuar në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Dixhitalb sha që morrën pjesë në votim.

Vjollca Hoxha

Vjollca HOXHA **LORESA SHPK**

ITAN HOXHA **REDIA HOXHA**

Vjollca Hoxha

VENDIM
I
ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
DIGITALB Sha

Nr.____ Datë_17/01/2019

Sot, më datë 17.01.2019, ora 16.pm në selinë e shoqërisë Dixhitalb sha, me kërkesë dhe në zbatim të vendimit të datës 20.12.2018të Këshillit të Mbikëqyrës u mblodh Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshm të Shoqërisë Dixhitalb sha.

Bazuar në vendimin e datës 20.12.2018të Këshillit të Mbikëqyrës, thirrja e kësaj Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme ka për rend dite:

v) Miratimin e projekt buxhetit të **shoqërisë Dixhitalb sha** përgatitur sipas kërkesës së Uni Credit.

w) Diskutim mbi raportin e përgatitur nga administratori i shoqërisë mbi projeksionin e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për vitet 2018-2020 të përgatitur sipas kërkesave të UniCredit.

x) Përgatitjen nga ana e Administratorit të shoqërisë të një raporti analitik nëpërmjet të cilit të informohen aksionerët e shoqërisë për aktivitetin dhe administrimin e përmuajshëm të shoqërisë, referuar periudhës Janar–Nëntor 2018, në të cilin të pasqyrohen këto çështje:***Arsyet për humbjen e bazës së klienteve në platformën Satelitore***, (fakt ky i pranuar në raportin e projeksionit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për vitet 2018-2020).***Cilat kanë qenë veprimet dhe aktet konkrete të admistratorit të shoqërisë për të ndaluar këtë rënie? A ka krijuar administratori një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për të gjithë rrethanat që kërcënojnë shoqërinë, nga humbja e bazës së klienteve në platformën Satelitore?***

y) Përgatitjen nga ana e Administratorit të shoqërisë të një raporti analitik nëpërmjet të cilit të informohen aksionerët e shoqërisë mbi **marrëdhëniet e shoqërisë të lidhura më të tretët**, duke sqaruar se ***mbi çfarë baze të dhënash dhe informacionesh është mbështetur administratori kur ka marrë vendime për të lidhur në emër dhe për llogari të shoqërisë marrëdhënie me të tretët. Cili ka qenë hetimi i bërë prej tij në lidhje me këto të dhëna dhe informacione***, si dhe ***cili ka qenë vlerësimi i tij konkret i mjaftueshëm, i bërë me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm, kur ai ka lidhur në kushte të caktuara këto marrëdhënie me të tretët***.Ky raport të fokusohet dhe ti referohet vetëm kontratave që janë në fuqi.

z) Përgatitjen nga ana e Administratorit të shoqërisë të një raporti analitik nëpërmjet të cilit të informohen aksionerët e shoqërisë mbi gjendjen aktuale të piraterisë, ***duke treguar se sa ka ndikuar konkretisht pirateria në uljen e të ardhurave të shoqërisë.Cilat kanë qenë veprimet dhe aktet konkrete të admistratorit të shoqërisë kundër fenomenit të piraterisë, dhe a ka krijuar administratori një sistem monitorimi e***

njoftimi të hershëm për të gjithë rrethanat që kërcënojnë shoqërinë, nga pirrateria. Cila është strategjia që duket adoptuar nga shoqëria për të reduktuar piraterinë.

aa) Vendimarrje të Asamblesë të Përgjithshme të aksionerëve mbi raportet e sipërcituara të përgatitura nga Administratori i Shoqërisë.

bb) Raportet e sipërcituara të përgatitura nga administratori duhet të depozitohen në selinë e shoqërise, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

Ngarkohej Admistratori i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Duke qenë se administrator i shoqërisë z. Alban JAHO, në shkelje të rëndë dhe flagrante të detyrave që i kishte ngarkuar Këshilli i Mbikëqyres me vendimin e datës_20.12.2018, detyra që kanë të bëjmë me administrimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë, si dhe në shkelje të rëndë dhe flagrante të dispozitave ligjore dhe statutore dhe konkretisht: nenit 154 gërmat "a" dhe "ç" në referencë të neneve 166 dhe 167, nenit 158 pika 3 gërmat "a" "ç" dhe "d", nenit 163 pika 1 gërmat "a","c", e "dh" të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" , dhe nenit 19 të Statutit të shoqërisë "Dixhitalb" sha, nuk kishte përgatitur, paraqitur dhe vënë në dispozicion të Mbledhjes të Asamblesë së Përgjithshm të Shoqërisë Dixhitalb sha, asnjë dokumentacion që të adresonte çështjet e rendit të ditës së kësaj Mbledhje te Asamblesë së Përgjithshm të Shoqërisë Dixhitalb sha,

Asambleja e Përgjithshmë e Shoqërisë Dixhitalb sha, u njoh mbi vendimin e aksioneres Vjollca Hoxha, e cila perfaqeson shumicen e nevojshme prej 51% te aksionareve ne kete Mbledhje, per shkarkimin e z. Alban JAHO si administrator i shoqërisë "Dixhitalb" sha," duke marrë parasysh shkeljet flagrante e të rënda të ligjit, si dhe për shkak se për këtë vendimarrje plotësohej kushti i kuorumit i parashikuar në nenin 144 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare", pasi aksionarët e pranishëm/ të përfaqësuar në këtë mbledhje zotëronin më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote, bazuar në nenet 18 dhe 20 të Statutit të shoqërisë "Dixhitalb" sha, si dhe në nenin 134 pika 1 gërma "c", nenin 135 pika 2 gërma "c", nenin 167 pika 2, të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare", me votim të hapur, me shumicë votas,

vendosi:

-Caktimin e z/znj_Vjollca Hoxha dhe Arben Taipi qe të ushtrojnë përkohësisht funksionin e administratorit të shoqërisë, deri në emërimin e admistratorit të ri sipas përcaktimeve ligjore e statutore nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Dixhitalb sha.

-Në zbatim të këtij vendimi z. Alban JAHO detyrohet që brenda ditës së sotme, datë 17.01.2019, tia dorëzojë nëpërmjet një procesverbali ambientet dhe mjetet e punës, si dhe gjithë dokumentacionin shkresor dhe elektronik të administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, z/znj_Vjollca Hoxha dhe Arben Taipi te cilet do të ushtrojnë përkohësisht funksionin e administratorit të shoqërisë, deri në emërimin e admistratorit të ri sipas përcaktimeve ligjore e statutore nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Dixhitalb sha.

Pikat e tjera te rendit te dites sipas vendimit te Keshillit Mbikqyres te dates 20.12.2018 do te shqyrtohen ne nje date tjeter e cila do te komunikohet nga administratoret e perkohshem.

Aksionarët e pranishëm/ të përfaqësuar në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Dixhitalb sha që morrën pjesë në votim.

Vjollca HOXHA	**Edmond LEKA**	**Petraq SHOMO**
Vjollca Hoxha		
dv (pro)	**dv ()**	**dv ()**
EX.E INVESTMENT.		
Arben TAIPI	**Eduart PODA**	**Enkelejd Joti**
Arben Taipi		
dv ()	**dv ()**	**dv ()**

V E N D I M
I
ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

Nr. 1 Date 20/05/2019

Sot, me date 20.**05.2019** ne oren 11:00 ne seline e shoqerise "DigitAlb" sh.a u mblodh Asambleja e Pergjithshme e shoqerise "Digit-Alb" ne zbatim te nenit 136 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar).

Pasi u verifikua pjesmarrja e perfaqesuesve te saj, rezultoi se jane te pranishem ne mbledhje Aksionaret qe perfaqesojne 50.98% te kuotave te shoqerise te cilet konfirmuan se jane njoftuar rregullisht per zhvillimin e kesaj mbledhje.

Fjalen e merr zj. Vjollca Hoxha ne cilesine e Kryetares se mbledhjes e cila pasi verifikon se eshte krijuar kuorumi i parashikuar ne ligji, relaton se, ne kushtet kur Asamblese i eshte paraqitur doreheqja e saj ne cilesine e anetares se Keshillit Mbikeqyres, lind nevoja e emerimit te nje anetari te ri per te plotesuar kete vakance. Gjithashtu, Asamblese i eshte paraqitur edhe doreheqja e administratorit Arben Taipi, doreheqje te cilen Asamblese i kerkohet ta miratoje.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme ka per rend dite:

- Pranimin e doreheqjes se anetares se Keshillit Mbikeqyres,zj. Vjollca Hoxha
- Emerimin e nje anetari te ri te Keshillit Mbikeqyres.
- Pranimin e doreheqjes se Administratorit Arben Taipi.

Ne perfundim te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, pasi u diskutua rendi i dites, mbeshtetur ne nenin 135.2.c) te ligjit nr.9901 date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe te Statutit te Shoqerise "DigitAlb" sh.a, Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise,

V E N D O S I:

1. Te pranoje doreheqjen e Anetares se Keshillit Mbikeqyres, zj. Vjollca Hoxha.
2. Te emeroje z. Redi Lamaj, te birin e Aliut, shtetas shqiptar lindur me 29.05.1983 ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 033385396 me numer personal I30529116C, ne detyren e Anetarit te Keshillit Mbikeqyres te shoqerise Digitalb sh.a. Mandati i anetarit Redi Lamaj do te jete me efekt qe nga data e ketij vendimi deri me 17.05.2020.
3. Te pranoje doreheqjen e Administratorit Arben Taipi.
4. Ngarkohet administratorja Vjollca Hoxha per regjistrimin e ketij vendimi personalisht apo nepermjet personave te autorizuar, prane Qendres Kombetare te Biznesit.

AKSIONARET
Shoqeria Digit - Alb SH.A

Itan Hoxha Vjollca Hoxha

Redia Hoxha Redia Hoxha

Per: "LORESA" SH.P.K
Administratori Lorela HOXHA
Lorela Hoxha

[1] Itan Hoxha, shtetas shqiptar, i mitur nen pergjegjesine e vetme prinderore te nenes se tij Znj. Vjollca Hoxha, mbajtes i pasaportes me numer BB8082282, e cili ne perputhje me nenin 232 dhe 233 te Ligjit nr 9062 per Kodin e Familjes perfaqesohet plotesisht nga Znj. Vjollca Hoxha.

V E N D I M

I

ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

Nr. 5 Datë 04/12/2019

Sot, më datë **04/12/2019** në orën 18:00 në selinë e shoqërisë "Digit-Alb" sh.a u mblodh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, në zbatim të nenit 136 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".
Pasi u verifikua pjesmarrja e përfaqësuesit të saj, rezultoi se ai është i pranishëm në mbledhje dhe konfirmoi se është njoftuar rregullisht për zhvillimin e kësaj mbledhje sipas procedurës së përcaktuar në ligj dhe në Statut.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ka për rend dite:

- Emërimin e anëtareve të këshillit mbikqyrës për shkak të heqjes dorë nga detyra të anëtarit Ilir Karaguni;
- Emërimin e anëtareve të këshillit mbikqyrës për shkak të shkarkimit të tyre;

Në përfundim të mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, pasi u diskutua rendi i dites, mbështetur në nenin 135 te ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe të Statutit e Shoqërisë "Digit-Alb" sh.a, Asambleja e Pergjithshme e Shoqërisë,

V E N D O S I:

1. Të shkarkojë nga detyra anëtarin e këshillit mbikqyrës z.Eduard Poda dhe të emërojë në vënd të tij në detyrën e Anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Digi-Alb" sh.a, Znj.Elena Bardhi identifikuar me letërnjoftimin nr.033711354, me afat duke filluar nga data 05.12.2019 deri më 17.05.2020.

2. Të shkarkojë nga detyra anëtarin e këshillit mbikqyrës znj.Iva Çamuku dhe të emërojë në vënd të tij në detyrën e Anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Digi-Alb" sh.a, Znj.Enkeleda Bullari identifikuar me letërnjoftimin nr.032043959, me afat duke filluar nga data 05.12.2019 deri më 17.05.2020

DigitAlb

3. Të pranojë dorëheqjen nga detyra te anetarit Ilir Karaguni dhe të emërojë në detyrën e Anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Digit-Alb" sh.a, Z.Redi Ajazi identifikuar me letërnjoftimin nr.024742003, me afat duke filluar nga data 05.12.2019 deri më 17.05.2020.

4. Të kryhen veprimet e nevojshme nga Administratori i Digit-Alb për depozitimin në Q.K.B të këtij vendimi.

AKSIONERI /AKSIONERET
Shoqëria Digit-Alb SH.A
Përfaqësuar nga:

Z. Itan HOXHA (perfaqesuar nga Ilir Dode me autorizim)

Ilir Dode

Z. Redia HOXHA (perfaqesuar nga Ilir Dode me autorizim)

Ilir Dode

Z. Enkelejdi JOTI

Z. Eduard PODA

DEM Capital
Administratori Petraq Shomo

E&E Investment
Administratori Arben Taipi

UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA
Administratori Ilir Karaguni

UNION GROUP SHPK
Administratori Niko Leka

LORESA SHPK
Administratori Lorela Hoxha (perfaqesuar nga Ilir Dode me autorizim)

Ilir Dode

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTER:ALKET Z. MANÇKA

PULLE TARIFE 200 LEKE

NR. 1573 **REP .**

VERTETIM
(I NJESIMI ME ORIGJINALIN)

Sot, ne date 28 /04/2020, para meje Noter Alket Z. Mançka, Anetar i Dhomes se Noterise Tirane, me zyre Rruga " Asim Zeneli" Pll. Nr. 10, Tirane, u paraqit personalisht Pala e interesuar si me poshte:

ZNJ.EGLANTINA LAMAJ, atesia Faredin, datelindje 30.08.1980, identifikuar me karte identiteti me Nr.Personal I05830144H, madhore dhe e aftë për të kryer veprime juridike, e cila kerkoi vertetimin e njesise me origjinalin, Ekstrakt nga dokumenti origjinal ku dhe paraqiti Dokumentin origjinal:

- Vendim i Asamblese se Pergjithshme, date 26.02.2020

Praktika permban 05 flete dhe eshte fotokopjuar per tu perdorur sipas kerkesave te Ligjit.
Personit qe e paraqiti ju be e qarte pergjegjesia penale ne ngarkim te saj, ne rast prodhimi, paraqitje apo perdorimi te nje Dokumenti te rreme apo te falsifikuar.

Une, Noteri deklaroj se mora pelqimin e Pales per perdorimin e te dhenave personale. Keto te dhena jane konfidenciale dhe u perdoren vetem per krijimin dhe redaktimin e ketij Akti, ne zbatim te Ligjit nr.9887, date 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale", i ndryshuar.

Une Noteri, pasi bera verifikimin e Dokumentit te fotokopjuar me Origjinalin e paraqitur, konstatova se fotokopja e Dokumentit eshte e rregullt, me fshirje, korigjime apo shtesa dhe e vertetoj ate ne baze Ligjit 110/2018 date 20.12.2018 "Mbi Noterine" i ndryshuar, Nenit 62 dhe pikes 3,4,7 te Udhezimit te Ministrit te Drejtesise, nr. 6291, date 17.08.2005.

NOTER
ALKET Z. MANÇKA

VENDIM

I

ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME

Nr.____ Datë_____/_____/2020

Sot, më datë **26 shkurt 2020** në orën 10:00 në ambjentet e Hotel Rogner Tirana ne Tirane, u mblodh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "Digit-Alb" sh.a në zbatim të nenit 136 e ne vijim të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), ketu e ne vijim "Ligji/t/n Tregtar" dhe nenit 13 dhe 14 te Statutit te DigitAlb sh.a (ketu e ne vijim "Statut/i/n").

a. Deklarime paraprake per mbledhjen sipas Ligjit Tregtar:

- Mbledhja eshte thirrur sipas njoftimit te dates 21.02.2020 te percjelle me poste elektronike nga Administratori tek te gjithe Aksionaret e shoqerise Digit-Alb sh.a sic figurojne ne ekstaktin e shoqerise ne daten 30.01.2020, qe perfshin shtyrjen e mbledhjes se dates 20.02.2020 me miratimin e shumices se Aksionareve dhe bashkimin e saj edhe me mbledhjen e dates 21.02.2020 te njoftuar nga Administratori, bashke me rendin e dites se seciles prej dy mbledhjeve; Njoftimet bashkelidhur.
- Te gjithe aksionaret prezent ne mbledhje deklarojne se kane marre njoftimin rregullisht me poste elektronike per pjesmarrjen ne kete mbledhje sic parashikohet ne Ligjin Tregtar dhe ne Statut; Sa me siper, plotesisht ne zbatim te nenit 138 pika 4 te Ligjit Tregtar.

Pasi u verifikua pjesmarrja e përfaqësuesve të saj, rezultoi se janë të pranishëm në mbledhje Aksionaret si vijon:

- Aksionari individ: **Alba Gina**, e perfaqesuar me prokure nga Aleksander Frangaj (me prokuren nr.956 Repertori nr.398 Koleksioni date 24/02/2020);

- Aksionari individ: **Agim Zeqo,** merr pjese personalisht ne mbledhjen e Asamblese;
- Aksionari individ: **Enkelejdi Joti**, merr pjese personalisht ne mbledhjen e Asamblese;
- Aksionari individ: **Alban Jaho**, i perfaqesuar me prokure nga Kriselda Dine (me prokuren nr.1093 Repertori nr.432 Koleksioni date 26/02/2020);
- Aksionari individ **Itan Hoxha**, ne moshe minore perfaqesohet nga Kujdestari Ligjor Vjollca Hoxha; perfaqesuar me autorizim nga Lulzim Alushaj (nr.240 prot date 24/02/2020);
- Aksionari individ **Redia Hoxha**, e perfaqesuar me autorizim nga perfaqesuar me autorizim nga Lulzim Alushaj (nr.240 prot date 24/02/2020);
- Aksionari individ **Samir Mane**, merr pjese personalisht ne mbledhjen e Asamblese;
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**A.I.B.A Kompani**" sh.a, me perfaqesues ligjor z.Andi Duka, i perfaqesuar me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise, nga Armand Duka te date 21/02/2020.
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**Arch Investor**" sh.p.k, me perfaqesues ligjor Niko Leka, i perfaqesuar me prokure nga Enklid Milaj (me prokuren nr.387 Repertori nr.189 Koleksioni date 17/02/2020);
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**DEM Capital**" sh.p.k, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor Petraq Shomo;
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**E&E Investment**" sh.p.k, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor Arben Taipi;
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**Loresa**" sh.p.k, me perfaqesues ligjor Lorela Hoxha, perfaqesuar me autorizim nga Lulzim Alushaj (nr.240 prot date 24/02/2020);
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**Union Distribution Service Albania**" sh.p.k, me perfaqesues ligjor Ilir Karaguni, perfaqesuar me prokure nga Enklid Mihaj (prokure nr.389 Repertori nr.191 Koleksioni date 17/02/2020);

- Aksionari person juridik: Shoqeria **"Union Grup"** sh.a, me perfaqesues ligjor Niko Leka, perfaqesuar me prokure nga Enklid Mihaj (prokure nr.388 Repertori nr.190 Koleksioni date 17/02/2020);
- Aksionari individ: **Eduard Poda** merr pjese ne mbledhje i lidhur me telekonference ne oren 19:28.

Ne mbledhje eshte prezent ne funksionin e Administratorit te perkohshem te shoqerise DigitAlb sh.a zj.Vjollca Hoxha;

Lista e Aksionareve te pranishem sipas percaktimeve nenit 141 pika 3 te Ligjit Tregtar i nenshkruhet se bashku me kete vendim dhe firmoset nga te gjithe Aksionaret prezent ne mbledhje dhe perfaqesuesit e tyre me prokure dhe autorizim.

b. Rendi i dites:

Sipas njoftimit per thirrjen e mbledhjes, mbledhja e thirrur per daten 20.02.2020 ka si rend dite si vijon:

1. ***"Anullimin e vendimeve te marra nga Asambleja e Pergjithshme e shoqerise Digit-Alb ne daten 04.12.2019 te publikuara prane Qendres Kombetare te Bisnesit (ne daten 16.12.2019).Vleresimine vendimarrjeve te tjera te kryera ne mbledhjet e dates 04.12.2019 dhe 26.12.2019, me qellim vleresimin e ligjshmerise se tyre ne mbledhjen e rregullt te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise Digital-Alb sh.a. Venien ne dispozicion te Aksionareve te Digit-Alb te procesverbaleve te mbledhjeve te mbajtura ne daten 04.12.2019 dhe 26.12.2019, ne formen shkresore dhe regjistrimet audio 8 dite para zhvillimit te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme brenda dates 12 shkurt 2020 ora 17:00 (ne zbatim te nenit 143 te Ligjit Tregtar).***
2. ***Kryerjen e pagesave te parapembetura te kesteve te papaguara per Aksionaret e Shitesit sipas Marreveshjes Kuader me nr.684 Rep dhe Nr.102 Kol date 10.03.2010 (te ndryshuar) per kestin e muajit shtator 2019 dhe dhjetor 2019;***

3. *Shqyrtim i kerkesave per Doreheqje te Anetareve te Keshillit Mbikeqyres Edmond Leka dhe Petraq Shomo (ne zbatim te nenit 157/4 te Ligjit Tregtar);*
4. *Riformatimin i Keshillit Mbikeqyres te Shoqerise DigitAlb sh.a ne kuader te doreheqjeve te paraqitura nga Anetaret e Keshillit Mbikeqyres (ne zbatim te nenit 135 pika 2/c, dhe nenit 22 pika 1 te Statutit te shoqerise);*
5. *Shkarkimin e Administratorit te perkohshem te shoqerise Digitalb sh.a (ne zbatim te nenit 135 pika 2/c, nenit 167 pika 2 te ligjit tregtar dhe nenit 18 pika 1 te Statutit te shoqerise);*
6. *Emerimi i Administratorit te ri te shoqerise DigitAlb sh.a. (ne zbatim te nenit 135 pika 2/c, nenit 167 pika 2 te ligjit tregtar dhe nenit 18 pika 1 te Statutit te shoqerise);*

   Vleresimin e kandidaturave te paraqitura nga cdo Aksionar gjate perudhes 21 ditore deri ne daten e mbledhjes dhe/ose kandidatura te propozuara direkt ne mbledhje. Kandidaturat do te paraqitet dhe/ose propozohen bashke me CV e kandidatit".

Sipas njoftimit per thirrjen e mbledhjes, mbledhja e thirrur per daten 21.02.2020 ka si rend dite si vijon:

7. *Vendim per emerimin e dy anetareve te rinj te Keshillit Mbikeqyres si pasoje e vakances se krijuar nga doreheqjet e paraqitura nga Petraq Shomo dhe Edmond Leka ne daten 30.12.2019;*

Asambleja ra dakort qe mbledhja te drejtohet nga **z.Armando Duka,** i cili ben me dije rregullat e zhvillimit te mbledhjes se dates 26..02.2020.

Me konsensus te gjithe Aksionaret me unanimitet rane dakort qe te diskutohet dhe te vendoset vetem per ceshtjet e meposhtme.

Në zbatim te nenit 135, 144, 145, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë "DigitAlb" sh.a, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me voten "pro" te 97% te Aksionareve dhe voten "kunder" te Aksionarit Alban Jaho,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin me efekt te menjehershem te nenit 18 te Statutit te shoqerise DigitAlb sh.a si vijon:

   Neni 18

   Emerimi i Administratorit

   a. *Asambleja e Pergjithshme zgjedh nje ose disa Administratore te shoqerise, per nje periudhe jo me gjate se 3 vjet, sipas nenit 158 te Ligjit Tregtar. Kompetencat ne rastin e emerimit te me shume se nje Administratori te shoqerise percaktohen ne vendimin e emerimit perkates nga Asambleja e Pergjithshme. Vendimet e emerimit te Administratorit do te merren sipas nje vendimi me shumice te cilesuar/kualifikuar te Asamblese se Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratorin nga detyra;*

   b. *Anetaret e Keshillit Mbikeqyres nuk mund te caktohen si Administrator. Asnje nga Aksionaret apo palet e lidhura me to (sic percaktohet ne nenin 13 te Ligjit Tregtar) nuk mund te zgjidhet Administrator. Kufizime te tjera lidhur me emerimin e Administratoreve parashikohen ne piken 2 te nenit 158 te Ligjit;*

2. Administratori aktual Vjollca Hoxha do te jete ne detyre deri ne daten **09.04.2020**, date ne te cilen i perfundon mandati i emerimit te saj ne kete funksion, pa te drejte shtyrje afati, sipas vullnetit te saj te lire. Cdo vendim i marre nga Administratori qe largohet nga detyra pas dates 09.04.2020 (data e perfundimit te mandatit te tij) eshte i pavlefshem per shoqerine DigitAlb dhe palet e treta.
3. Z.Redi Ali Lamaj identifikuar me leternjoftimin nr.I30529116C emerohet ne detyren e Administratorit me efekt nga data **10.04.2020** dhe Znj.Eglantina Faredin Lamaj identifikuar me leternjoftimin me numer I05830144H emerohet ne detyren e Administratorit me efekt nga data **10.04.2020**.
4. Perfundimi i afatit te emerimit per te dy administratoret eshte 09/08/2020.
5. Te dy Administratoret e zgjedhur sipas pikes 3 te ketij vendimi do te administrojne shoqerine per afatin nga 10.04.2020 deri ne daten 09.08.2020 ne menyre te perbashket qe nenkupton firmen e perbashket ne nenshkrimin e cdo akti dhe kryerjen e cdo veprimi ne zbatim te kompetencave ligjore dhe statutore.
6. Te vendoset dispozite tranzitore ne Statutin e shoqerise DigitAlb sh.a, per afatin 10.04.2020 deri me 09.08.2020 vetem per rastin e parashikuar ne vijim:
   Shkarkimi nga detyra i 1 (nje) prej Administratoreve per cdo lloj arsye, konsiderohet dhe ekzekutohet automatikisht si shkarkim edhe per Administratorin tjeter. Pavaresisht ketij shkarkimi Administratoret qendrojne ne detyre deri ne emerimin e Administratorit te ri sipas pikes 4 te ketij vendimi.
7. Me hyrjen ne fuqi te ketij vendimi dhe ne cdo rast para perfundimit te afatit te emerimit te dy Administratoreve te zgjedhur sipas pikes 3 te ketij vendimi, Aksionaret bien dakort te zgjedhin Administratorin e ri. Te drejten ekskluzive per propozimin e Administratorit te ri vetem ne kete rast (ad hoc) e kane Aksionaret: Shoqeria "Loresa" sh.p.k, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha.

8. Ngarkohet Administratori i shoqerise me date 08.04.2020 të kryejë veprimet e nevojshme për depozitimin dhe regjistrimin në Q.K.B të këtij vendimi. Nese prej Administrarorit ky vendim nuk do te depozitohet ne kete date, atehere cdo Aksioner apo person i autorizuar prej tij do te kryej veprimet e nevojshme për depozitimin dhe regjistrimin ne Q.K.B.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mbyllet ne oren 21:00 dhe Aksionaret e pranishem qe votuan nenshkruajne me vullnetin e tyre te lire kete vendim ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

Vendimi ka 8 faqe dhe neshkruhet ne 15 kopje te njejta origjinale me te njejten vlere.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

AKSIONARET

Shoqëria Digit – Alb Sh.a

Alba GINA **Agim Zeqo** **Enkelejdi JOTI**

Eduard Poda **Redia Hoxha** **Samir Mane**

Itan Hoxha **Alban JAHO**

Për: "Union Distribucion Service Albania" SH.P.K*

Për: "Union Grup" SH.A *

Për: "A.I.B.A KOMPANI" SH.A*

Per: "DEM Capital" SH.P.K

Petraq Shamo

L51615012T DEM Capital Tirana - Albania

Per: "Arch Investor" SH.P.K*

L51616023Q E&E Investment Tirana - Albania

Për: "LORESA" SH.P.K*

Lulzim Alushaj

Per "E&E Investment" sh.p.k

Arben Tafa

V E N D I M
I
ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME
Nr. 2. Datë 06 / 03 /2020

Sot, më datë **06 mars 2020** në orën 10:00 në seline e DigitAlb sh.a ne Tirane, u mblodh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "Digit-Alb" sh.a në zbatim të nenit 136 e ne vijim të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), ketu e ne vijim "Ligji/t/n Tregtar" dhe nenit 13 dhe 14 te Statutit te DigitAlb sh.a (ketu e ne vijim "Statut/i/n").

a. Deklarime paraprake per mbledhjen sipas Ligjit Tregtar:

- Mbledhja eshte thirrur sipas njoftimit te dates 28.02.2020 ora 15:53, te percjelle me poste elektronike nga znj.Jeronima Lulashi ne emer dhe per llogari te Aksionarit A.I.B.A sh.a, tek te gjithe Aksionaret e shoqerise dhe eshte vazhdim i mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te DigitAlb te dates 26.02.2020 e cila e shty per nje mbledhje vijuese per shkak te ores se vone (mbledhja e dates 26.02.2020 nisi ne oren 10:00 dhe perfundoi ne oren 22:00). (Mbledhja eshte thirrur sipas njoftimit te dates 21.02.2020 te percjelle me poste elektronike nga Administratori tek te gjithe Aksionaret e shoqerise Digit-Alb sh.a sic figurojne ne ekstaktin e shoqerise ne daten 30.01.2020, qe perfshin shtyrjen e mbledhjes se dates 20.02.2020 me miratimin e shumices se Aksionareve dhe bashkimin e saj edhe me mbledhjen e dates 21.02.2020 te njoftuar nga Administratori, bashke me rendin e dites se seciles prej dy mbledhjeve); Njoftimi bashkelidhur.
- Te gjithe aksionaret prezent ne mbledhje deklarojne se kane marre njoftimin rregullisht me poste elektronike per pjesmarrjen ne kete mbledhje sic parashikohet ne Ligjin Tregtar dhe ne Statut; Sa me siper, plotesisht ne zbatim te nenit 138 pika 4 te Ligjit Tregtar.

Pasi u verifikua pjesmarrja e përfaqësuesve të saj, rezultoi se janë të pranishëm në mbledhje Aksionaret si vijon:

- Aksionari individ: **Alba Gina**, e perfaqesuar me prokure nga Aleksander Frangaj (me prokuren nr.956 Repertori nr.398 Koleksioni date 24/02/2020);
- Aksionari individ: **Agim Zeqo,** merr pjese personalisht ne mbledhjen e Asamblese;
- Aksionari individ: **Alban Jaho**, i perfaqesuar me prokure nga Kriselda Dine (me prokuren nr.1093 Repertori nr.432 Koleksioni date 26/02/2020);
- Aksionari individ **Itan Hoxha**, ne moshe minore perfaqesohet nga Kujdestari Ligjor Vjollca Hoxha; perfaqesuar me autorizim nga Azmi Stringa (nr.287 prot date 04/03/2020);
- Aksionari individ **Redia Hoxha**, e perfaqesuar me autorizim nga perfaqesuar me autorizim nga Azmi Stringa (nr.287 prot date 04/03/2020);
- Aksionari individ **Samir Mane**, i perfaqesuar me prokure nga Agim Zeqo (me prokuren nr.13388 Rep dhe Nr.516 Kol)
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**A.I.B.A Kompani**" sh.a, me perfaqesues ligjor z.Andi Duka, i perfaqesuar me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise, nga Armand Duka te date 21/02/2020.
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**Arch Investor**" sh.p.k, me perfaqesues ligjor Niko Leka, i perfaqesuar me prokure nga Enklid Milaj (me prokuren nr.387 Repertori nr.189 Koleksioni date 17/02/2020);
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**DEM Capital**" sh.p.k, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor Petraq Shomo;
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**E&E Investment**" sh.p.k, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor Arben Taipi;
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**Loresa"** sh.p.k, me perfaqesues ligjor Lorela Hoxha, perfaqesuar me autorizim nga Azmi Stringa (nr.287 prot date 04/03/2020);
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**Union Distribution Service Albania**" sh.p.k, me perfaqesues ligjor Ilir Karaguni, perfaqesuar me prokure nga Enklid Mihaj (prokure nr.389 Repertori nr.191 Koleksioni date 17/02/2020);
- Aksionari person juridik: Shoqeria "**Union Grup**" sh.a, me perfaqesues ligjor Niko Leka, perfaqesuar me prokure nga Enklid Mihaj (prokure nr.388 Repertori nr.190 Koleksioni date 17/02/2020);

Ne mbledhje nuk prezent ne funksionin e Administratorit te perkohshem te shoqerise DigitAlb sh.a zj.Vjollca Hoxha; Administratori nuk u paraqit ne mbledhje per afatin prej 15 min nga fillimi i saj sipas nenit 14/3 te Statutit te DigitAlb dhe mbledhja vijoi ne mungese te saj. Ne mbledhje eshte prezent Drejtori i Pergjithshem Redi LAMAJ.
Jane njoftuar rregullisht per mbledhjen dhe rendin e dites Aksionaret Eduard Poda dhe Enkelejdi Joti te cilet nuk jane prezent ne mbledhje.

Lista e Aksionareve te pranishem sipas percaktimeve nenit 141 pika 3 te Ligjit Tregtar i nenshkruhet se bashku me kete vendim dhe firmoset nga te gjithe Aksionaret prezent ne mbledhje dhe perfaqesuesit e tyre me prokure dhe autorizim.

b. Rendi i dites:
Sipas njoftimit per thirrjen e mbledhjes, mbledhja e thirrur per daten 20.02.2020 ka si rend dite te mbetur pa u trajtuar si vijon:

1. "Anullimin e vendimeve te marra nga Asambleja e Pergjithshme e shoqerise Digit-Alb ne daten 04.12.2019 te publikuara prane Qendres Kombetare te Bisnesit (ne daten 16.12.2019).Vleresimine vendimarrjeve te tjera te kryera ne mbledhjet e dates 04.12.2019 dhe 26.12.2019, me qellim vleresimin e ligjshmerise se tyre ne mbledhjen e rregullt te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise Digital-Alb sh.a. Venien ne dispozicion te Aksionareve te Digit-Alb te procesverbaleve te mbledhjeve te mbajtura ne daten 04.12.2019 dhe 26.12.2019, ne formen shkresore dhe regjistrimet audio 8 dite para zhvillimit te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme brenda dates 12 shkurt 2020 ora 17:00 (ne zbatim te nenit 143 te Ligjit Tregtar).

2. Kryerjen e pagesave te parapembetura te kesteve te papaguara per Aksionaret e Shitesit sipas Marreveshjes Kuader me nr.684 Rep dhe Nr.102 Kol date 10.03.2010 (te ndryshuar) per kestin e muajit shtator 2019 dhe dhjetor 2019;

3. Shqyrtim i kerkesave per Doreheqje te Anetareve te Keshillit Mbikeqyres Edmond Leka dhe Petraq Shomo (ne zbatim te nenit 157/4 te Ligjit Tregtar);

4. Riformatimin i Keshillit Mbikeqyres te Shoqerise DigitAlb sh.a ne kuader te doreheqjeve te paraqitura nga Anetaret e Keshillit Mbikeqyres (ne zbatim te nenit 135 pika 2/c, dhe nenit 22 pika 1 te Statutit te shoqerise);

5. Emerimi i Administratorit te ri te shoqerise DigitAlb sh.a. (ne zbatim te nenit 135 pika 2/c, nenit 167 pika 2 te ligjit tregtar dhe nenit 18 pika 1 te Statutit te shoqerise);
Vleresimin e kandidaturave te paraqitura nga cdo Aksionar gjate perudhes 21 ditore deri ne daten e mbledhjes dhe/ose kandidatura te propozuara direkt ne mbledhje. Kandidaturat do te paraqitet dhe/ose propozohen bashke me CV e kandidatit".

Sipas njoftimit per thirrjen e mbledhjes, mbledhja e thirrur per daten 21.02.2020 ka si rend dite si vijon:

6. Vendim per emerimin e dy anetareve te rinj te Keshillit Mbikeqyres si pasoje e vakances se krijuar nga doreheqjet e paraqitura nga Petraq Shomo dhe Edmond Leka ne daten 30.12.2019;

7. Nisur nga rrethanat aktuale si dhe gjetjet e zbuluara rishtazi, diskutim ne lidhje me zgjidhjet e mundshme mbi rregullimin e pasojave qe kane krijuar Marreveshja Kuader Nr.684Rep Nr.102Kol e dates 10.03.2010, ndryshuar me aktin noterial Nr.4847 Rep Nr.2736 Kol date 18.12.2015, Marreveshja e Bashkimit me Perthithje te shoqerise "Supersport" sh.a nga shoqeria "DigitAlb" sh.a, si dhe Akt-Marreveshjet e dates 18.12.2015.

8. Diskutim mbi faktet e renda penale te konstatuara rishtazi ne pasqyrat financiare te shoqerise, te pergatitura nga ish Administratori Alban Jaho dhe ish shefja e finances Teuta Vrushi (Nuni) dhe te audituara nga ekspertet kontabel te shoqerise, te cilat kane sjelle pasoja te renda financiare per vete shoqerine.

Asambleja ra dakort qe mbledhja te drejtohet nga **z.Armando Duka,** i cili ben me dije rregullat e zhvillimit te mbledhjes se dates 06.03.2020.

Qendrimi i perfaqesuesit te Aksionareve: Loresa sh.p.k, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha:

1- Mbledhja nuk eshte thirrur nga Administratori bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi si edhe rendi i dites nuk eshte caktuar ne menyre te rregullt.
2- Jane futur pika ne Rend Dite te cilat nuk ishin njoftuar me pare.
3- Mbledhja nuk eshte vazhdim i mbledhjes se dates 26.02.2020 dhe ne kete kuader, duheshin respektuar parashikimet statutore dhe ligjore ne fuqi per nje Mbledhje te Rregullt ne menyre qe vendimarrja te konsiderohet ligjerisht e rregullt.
4- Si rezultat i te tre pikave me siper, shprehemi njezeri (Aksionaret e cituar) se kjo Mbledhje eshte e pavlefshme dhe se cdo projekt vendim i cituar me poshte eshte absolutisht i pavlefshem.

Per aksionaret e tjere prezent ne Mbledhje, qendrimi i perfaqesuesit te Aksionareve Loresa sh.p.k, Redia Hoxha, Itan Hoxha eshte teresisht i pabazuar ne Ligj dhe ne fakte, ne Statut, strumental, pretencioz, ne kundershtim te hapur me cfare u diskutua dhe u ra dakort me unanimitet mes Aksionareve dhe mbledhjen e dates 26.02.2020.

Në zbatim te nenit 135, 144, 145, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë "DigitAlb" sh.a, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me voten "pro" te 53.11 % te Aksionareve dhe voten "kunder" te 42.8 % te Aksionareve:

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.4 date 04.12.2019 nga Asambleja e Pergjithshme e DigitAlb;
2. Autorizimin e Administratorit te kryej pagesat e prapambetura te kesteve te papaguara per Aksionaret e Shitesit sipas Marreveshjes Kuader me nr.684 Rep dhe Nr.102 Kol date 10.03.2010 (te ndryshuar) per kestin e muajit shtator 2019 dhe dhjetor 2019.
3. Shkarkimin e te gjithe anetareve te Keshillit Mbikeqyres se DigitAlb.
4. Riformatimin dhe emerimin e Keshilli Mbikeqyres te DigitAlb ne daten 06.03.2020 me afat 1 vjecar deri me 05.03.2021 si vijon:
   - **Arben Taipi** – Anetar; Afati 06.03.2020 deri 05.03.2021; Identifikuar me numer personal G50401087C;
   - **Jeronima Lulashi** - Anetar; Afati 06.03.2020 deri 05.03.2021; Identifikuar me numer personal I15507052F;
   - **Petraq Shomo** - Anetar; Afati 06.03.2020 deri 05.03.2021; Identifikuar me numer personal G30107128Q;
   - **Gentiana Gjermeni**- Anetar; Afati 06.03.2020 deri 05.03.2021; Identifikuar me numer personal H55502046I;
   - **Aleksander Frangaj** –Anetar; Afati 06.03.2020 deri 05.03.2021; Identifikuar me numer personal G81004099S;
5. Rrezimin nga Asambleja e Pergjithshme e DigitAlb sh.a te raportit konfidencial te pergatitur nga Administratori i shoqerise dhe te bere me dije Aksionareve te DigitAlb ne mbledhjen e dates 04.12.2019.
6. Shtyhet diskutimi i pikes 8 te rendit te dites ne mbledhjen e ardhshme te Asamblese se Pergjithshme te DigitAlb per tu thirrur dhe per te qene i pranishem personalisht per tu degjuar Alban Jaho ne rolin e ish Administratorit. Ndalimin e cdo veprimtarie nga ana e Administratorit per ankime, kerkesa dhe/ose kallezime penale ose tjera te ngjashme prane institucioneve shteterore dhe/ose pale te treta per sa lidhet me piken 8 te rendit te dites.
7. I kerkohet Administratores te therrase mbledhjen e ardhshme te Asamblese se Pergjithshme ne daten **02 prill 2020 ne seline e DigitAlb ora 10:00** (ose ne nje date me te afert me konsensusin e te gjithe Aksionareve te dhene me poste elektronike), me rendin e dites si vijon:
   i. Diskutim mbi pasqyrat financiare te pergatitura nga ish Administratori dhe degjimin e tij per raportin e e pergatitur nga Administratori.

ii. Vleresimin e raportit vjetor mbi ecurine e veprimtarise tregtare dhe financiare per vitin 2019 te DigitAlb sh.a;
iii. Shqyrtimin e bilancit dhe pasqyrave financiare te shoqerise DigitAlb sh.a qe do dorezohen prane organit tatimor ne daten 31.03.2020, per vitin 2019;
iv. Shqyrtimin e kerkeses per doreheqje te auditorit ligjor dhe emerimin potencial te auditorit te ri.
v. Informacion ne lidhje me akt-marreveshjet e kompesimit te lidhura mes DigitAlb sh.a dhe Dem Capital sh.p.k, E&E Investment sh.p.k, UDSA sh.p.k dhe Union Grup sh.a te lidhura ne date 18.12.2015.
vi. Informim dhe diskutim mbi marredhenien kontraktore midis DigitAlb dhe Tibo. (percjellje paraprake e kontrates ne fuqi).
vii. Plotesim i Keshillit Mbikeqyres me Anetaret te tjere me propozim nga Aksionaret Loresa sh.p.k, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha.
viii. Te tjera qe gjykohen te pershtatshme nga Aksionaret dhe Administratori;
ix. Venie ne dispozicion te secilit Aksionar te DigitAlb te materialit audio te regjistruar ne mbledhjet e dates 26.02.2020 dhe 06.03.2020 brenda dates 13.03.2020.

8. Ngarkohet Administratori i shoqerise me date 09 mars 2020 të kryejë veprimet e nevojshme për zbatimin e ketij vendimi, depozitimin, regjistrimin dhe publikimin në Q.K.B të këtij vendimi.
Nese nga Administratori ky vendim nuk do te depozitohet ne kete date prane Q.K.B, atehere cdo Aksioner apo person i autorizuar prej tij do te kryej veprimet e nevojshme për depozitimin dhe regjistrimin ne Q.K.B.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mbyllet ne oren 14:00 dhe Aksionaret e pranishem qe votuan nenshkruajne me vullnetin e tyre te lire kete vendim ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.
Vendimi ka 4 faqe dhe neshkruhet ne 13 kopje te njejta origjinale me te njejten vlere.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

AKSIONARET
Shoqëria Digit – Alb Sh.a

Alba GINA | **Alban JAHO** | **Agim ZEQO**

Samir MANE

Për: "A.I.B.A Kompani" SH.A | **Per: "Arch Investor" SH.P.K**

Per: "DEM Capital" SH.P.K | **Per "E&E Investment" sh.p.k**

Për: "Union Distribucion Service Albania" SH.P.K | **Për: "Union Grup" SH.A**

Për: "LORESA" SH.P.K | **Redia Hoxha** | **Itan Hoxha**

V E N D I M

I

ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

Nr.04 Datë 28/05/2020

Sot, më datë 28 /05 /2020 në orën 13 : 30 në selinë e shoqërisë "Digit-Alb" sh.a u mblodh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, në zbatim të nenit 136 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".
Pasi u verifikua pjesmarrja e përfaqësuesve të saj, rezultoi se ato janë të pranishëm në mbledhje dhe konfirmuan se janë njoftuar rregullisht për zhvillimin e kësaj mbledhje sipas procedurës së përcaktuar në ligj dhe në Statut.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ka për rend dite:

- Emërimin e anëtareve të këshillit mbikqyrës si pasojë e vakancës së krijuar;

Konstatohet se:

- aksioneret e DIGITALB jane njoftuar ne menyre te rregullt per mbledhjen dhe per rendin e dites, ne perputhje me Statutin;

- kuorumi per te cilesuar mbledhjen si te vlefshme me qellim marrjen e vendimeve per rendin e dites eshte i permbushur ne perputhje me Statutin;

- pjesemarresit kane autoritetin dhe fuqine e nevojshme per te marre pjese ne mbledhje dhe per te nenshkruar vendimin ne perputhje me Statutin;

Në përfundim të mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, pasi u diskutua rendi i dites, mbështetur në nenin 135 te ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe të Statutit e Shoqërisë "Digit-Alb" sh.a, Asambleja e Pergjithshme e Shoqërisë,

V E N D O S I:

1. Të emërojë në detyrën e Anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Digi-Alb" sh.a, Znj.Vjollca Hoxha identifikuar me letërnjoftimin nr.G95323231L, me afat duke filluar nga data 28/05/2020 deri më 05/03/2021.

2. Të emërojë në detyrën e Anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Digi-Alb" sh.a, Z.Azmi Stringa identifikuar me letërnjoftimin nr.I60523059V, me afat duke filluar nga data 28/05/2020 deri më 05/03/2021.

3. Të kryhen veprimet e nevojshme nga Administratoret e Digit-Alb për depozitimin në Q.K.B të këtij vendimi.

AKSIONERET
Shoqëria Digit-Alb SH.A
Përfaqësuar nga:

Alba GINA

Alban JAHO

Agim ZEQO

Për: "A.I.B.A Kompani" SH.A

Për: "Arch Investor" SH.P.K

Samir MANE

Për: "DEM Capital" SH.P.K

Për: "E&E Investment" SH.P.K

Për: "Union Distribution Service Albania" SH.P.K

Për: "UNION GRUP" SH.A

Për: "LORESA" SH.P.K

Redia HOXHA

Itan HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 3152 REP

POLE TARIFE

PROCESVERBAL

VERIFIKIMI DHE VERTETIMI I DOKUMENTAVE

Sot ne daten 30/07/2020 (dymije e njezet), une noter Alket Z. Mançka me seli ne adresen Rr. "Asim Zeneli" Pll. Nr 10 Tirane , me kerkesen e **ZNJ.EGLANTINA LAMAJ,** atesia Faredin, datelindje 30.08.1980, identifikuar me karte identiteti me Nr.Personal I05830144H, madhore dhe e aftë për të kryer veprime juridike, realizova proceduren e meposhtme :

Kerkuesja deklaroi se eshte Administratore e adreses elektonike eglantina.lamaj@digitalb.tv dhe kerkoi nga une noteri qe te bej verifikimin e vertetimin e e-maileve te ruajtuar ne posten e saj elektronike eglantina.lamaj@digitalb.tv. Nga kerkimi qe u be ne e-mailin e saj, u verifikua dokumenti, i cili eshte bashkengjitur.

Ky procesverbal verifikimi dhe vertetimi te dokumentave u hartua nga une noteri Alket Z. Mançka me kerkesen e personit te interesuar.

Sa me siper une noteri redaktova kete procesverbal bazuar ne dispozitat e ligjit per Noterine i ndryshuar , neni 39 germa d) dhe gj) e tij, ne tre kopje te barazvlefshme , dhe vertetoj se te gjitha sa shpreha me siper tregojme besnikerisht dhe fjale per fjale gjendjen faktike dhe reale.

